



Pesë mite të pavërteta mbi shkatërrimin e Europës

Banka Botërore ngre alarmin për nivelet e borxhit dhe rënien ekonomike në Ballkanin Perëndimor
Bashkimit Europian i akordohet çmimi Nobel për Paqen, mes kritikave dhe ironizimit...


EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.12, Tetor - Nëntor 2012

Speciale

100 vjet në kërkim të vendit tonë në Europë



Muaji nëntor është nga hera muaji i rizgjimit të ndjenjave kombëtare dhe festimit, veçanërisht në diasporë. Ajo që përbën risi është se në këtë 100 vjetor të pavarësisë duket se njëfarë ndjenje më e fortë patriotike e ka pushtuar dhe Tiranën. Vështirë të gjendet politikan a figurë publike në

përgjithësi që të mos i referohet etërve themelues të shtetit të pavarur shqiptar dhe aktit të tyre solemn përpara një shekulli. Tema e pavarësisë duket një tjetër temë e rehatshme dhe e volitshme për tu përdorur në retorikën e shterpë të politikës shqiptare. Qytetarët ndërkohë duken mjaft receptivë ndaj kësaj retorike. Por, përpos rrahjes së gjoksit dita ditës, sa i takon organizimit të eventeve përkujtimore, festimet po

...vijon në faqen 2 >>

Kërkesat për Azil rezik serioz për regjimin pa viza



Në datat 5 dhe 6 nëntor u mbajt në Tiranë, Ministeriali për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme BE-Ballkan Perëndimor. Çështja me e rëndësishme që u diskutua kishte të bënte me shqetësimet e ngritura kohët e fundit nga disa vende anëtare për rritjen e fluksit të azilkërkuesve nga

Ballkani. Komisioneria për Çështjet e Brendshme te Komisionit Europian Cecilia Malstrom vuri në dukje se deri në shtator 2012 ka një rritje prej 73% të kërkesave krahasuar me vjet, e kërkoi një adresim energjik nga vendet e Ballkanit për të mos u ndeshur me mundësinë e pezullimit të regjimit pa viza. Disa vende si Gjermania, Belgjika, Suedia apo dhe Zvicra po shohin një rritje të vazhdueshme të

...vijon në faqen 3 >>

Zgjedhjet në SHBA, mesazhe të rëndësishme për Europën, por dhe për Shqipërinë



Zgjedhjet në SHBA ishin një betejë emocionuese e ndjekur me jo pak interes dhe në Europë. Ashtu siç 80% e europianëve do të kishin dashur po të mund të votonin (sipas një sondazhi të German Marshall Fund), Presidenti Barack Obama fitoi sërish. Fitorja e tij edhe pse më e ngushtë se para 4 vitesh, është cilësuar si themelore në shumë plane. Për disa analistë, pikërisht sepse nuk është më një fitore simbolike e një kandidati afro-amerikan, rikonfirmimi në post i Obamës tregon për suksesin e politikave të tij. Më

...vijon në faqen 3 >>

100 vjet në kërkim të vendit tonë në Europë

...vijon nga faqja 1 >>

shkojnë drejt një kulminimi të vakët.

Në këtë kulminim të vakët të 100 viteve shteti të pavarur shqiptar, natyrshëm lindin disa pyetje përtej dëshirës së "masave" për fishekzjarre: Cili është vendi që kemi ndërtuar në këto 100 vite dhe a kemi realisht arsye të jemi kaq krenarë? Ku ndodhemi për sa u takon ambicieve dhe vizionit tonë për të ardhmen e vendit? A është i nevojshëm një reflektim nga ana e aktorëve politikë mbi gjendjen e vendit dhe rolin e tyre në përcaktimin e të ardhmes?



Në pritje të një reflektimi të politikës shqiptare mbi ndikimin që ka tek e ardhmja e vendit (një reflektim që mund të mos ndodhë asnjëherë), një mënyrë për të analizuar këto 100 vite nga shpallja e pavarësisë është t'i shohim ato me sytë e familjes së vendeve ku duam të përkasim.

E kështu, e parë nga perëndimi, Shqipëria duket një vend i vogël që prej 100 vitesh përpiket të modernizohet e "të kthehet" në Europë, një përpjekje shumë e mundimshme e cila vazhdon dhe sot, herë me hapa përpara e herë me hapa mbrapa. Shqipëria ishte ndër vendet e fundit të cilat u shkëputën nga Perandoria Osmane në agoni. Pas shumë peripecish të luftërave botërore, Shqipëria e humbi rastin për të fituar që herët vendin e saj në Europë, duke zgjedhur rrugën e komunizmit radikal e më pas izolimit. Shqipëria ishte dhe vendi i fundit i bllokut komunist ku u rrëzua regjimi totalitar. Sigurisht, të shumtë janë faktorët që ndërhyjnë në fatet e një vendi dhe jo çdo pjesë e errët apo e pakëndshme e historisë sonë është një përgjegjësi vetëm e shoqërisë,

por për hir të së vërtetës, shqiptarët janë më të përgjegjshëm për historinë e dy dekadave të fundit. Prej 20 vitesh tashmë, shoqëria jonë lufton të rikthehet në Europë, lufton me apatinë dhe kufizimet e saj, lufton duke bërë një hap para e dy hapa mbrapa.

Përpara se të rrahim gjoksin për faktin se përpara 100 vitesh dikush mendoi të na lërë një vend tonin, për tu menaxhuar nga vetë ne, ndoshta duhet të rifitojmë kontakt me realitetin e të shohim cila është Shqipëria që kemi ndërtuar këto 20 vite?

Kemi përfutur një vend i cili ende përballet me vështirësi në garantimin e parimeve bazë të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, një të paftë të mbajë zgjedhje të ndershme, një vend simbol i korrupsionit dhe rekordeve negative në integrimin europian. E me këto problematika, nuk është për tu habitur që tashmë kemi humbur disa trena për në Europë. Nuk përbën çudi as imazhi negativ që Shqipëria gëzon në shumë vende anëtare të BE-së si dhe zhgënjimi i vazhdueshëm që ka shkaktuar klasa politike me egoizmin dhe refuzimin e saj të bëjë kompromisin më të vogël në të mirë të shoqërisë dhe të ardhmes së vendit. Duke parë rrjedhën e shoqërisë dhe jetës institucionale shqiptare në këto vite, ndjenja e krenarisë venitet disi.

Shqipërisë nuk i nevojiten festime pompoze për 100 vjetorin e pavarësisë apo retorika patetike politikanësh në prag fushate elektorale. Shoqërisë shqiptare i duhet një reflektim më i sqartë mbi stadin ku ndodhet dhe mënyrën si mund ta rigjejë orientimin e saj europian. I nevojitet angazhimi i eksponentëve përgjegjës t'i japin fund politikës përçarëse dhe dekonstruktive. Përpos reformave dhe progresit të prekshëm, asaj i duhet dhe një punë e jashtëzakonshme për të përmirësuar imazhin e vendit dhe fituar besimin e shoqërive europiane të na pranojnë në gjirin e tyre. Kur t'i kemi arritur të gjitha këto, do të kemi dhe më shumë arsye të festojmë e të ndihemi krenarë për vendin tonë.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2012



Zgjedhjet në SHBA, mesazhe të rëndësishme për Europën, por dhe për Shqipërinë

...vijon nga faqja 1 >>

tejt, kjo fitore është fitorja e klasës së mesme amerikane, e cila më parë rëndomtë diskutohej se nuk ekzistonte. Duke parë elektoratin, vota për Obamën përbën gjithashtu një votë shprese. Në fakt, Obama arriti të fitojë votat e të rinjve, të grave, të personave të minoriteve etnike e kulturore në SHBA dhe si zakonisht, votat e brigjeve, lindor e perëndimor - zonat më të zhvilluara të vendit.

Bashkë me këto mesazhe mbi fitoren e Presidentit Obama, për Europën, por dhe për Shqipërinë vijnë dy mesazhe e mësim për tu nxjerrë.

Para së gjithash, në fushatën e fundit elektorale për zgjedhjet presidenciale në SHBA u kuptua qartë se sa e parëndësishme është tashmë marrëdhënia me Europën. Në një botë ku superfuqi të reja tentojnë të afirmohen çdo ditë, duket se SHBA-të e marrin për të mirëqenë marrëdhënien me Europën dhe tashmë interesat e tyre po përqendrohen në vende të tjera. Mjafton të përmendim faktin se gjatë debatit të fundit të dy kandidatëve, fjala Europë nuk u përmend asnjëherë. Ky është në vetvete një tregues i zbehjes së rëndësisë së Kontinentit të Vjetër në sytë e amerikanëve.

Edhe një vend i vogël si Shqipëria mund të lexojë mesazhe të rëndësishme në fushatën për zgjedhjet presidenciale në një vend me influencë globale si SHBA-të. Një mesazh i rëndësishëm u vu në dukje gjatë vizitës së ish-Sekretares së Shtetit, Hillary Clinton. Ai ka të bëjë pikërisht me kulturën e bashkëpunimit dhe besimit mes palëve politike, e cila mungon në vendin tonë dhe prej kohësh mban peng progresin e vendit me anëtarësimin në BE. Dështimi i presidentit Obama për të marrë konsensusin e republikanëve në miratimin e paketës ligjore për shërbimin shëndetësor është vazhdimisht objekt kritikash të sarta. Përçarja dhe polarizimi i shoqërisë amerikane shihen me mjaft shqetësim. Kësisoj, sfida më e madhe e presidentit Obama është

të rindërtojë bashkëpunimin me pjesën republikane të elektoratit. Në mënyrë të ngjashme, dhe progresi i reformave në vendin tonë kushtëzohet nga qeverisja për të gjithë qytetarët e jo vetëm votuesit, nga vullneti i palëve për të bërë kompromise në të mirë të vendit.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2012

Kërkesat për Azil rrezik serioz për regjimin pa viza

...vijon nga faqja 1 >>

kërkesave të pajustificuara për azil. Qytetarët e Serbisë dhe Maqedonisë janë aplikuesit më të shumtë, por dhe ata shqiptarë ende paraqiten me shifra shqetësuese.

Rasti i Gjermanisë tregon më mirë këtë dinamikë negative. Në vitin 2010, qytetarët e Serbisë dhe Maqedonisë paraqitën 10.300 kërkesa për azil dhe në vitin 2011 numri u ul në 8.500. Ndërsa në shtator 2012, numri i shtetasve serbë dhe maqedonas që dorëzuan kërkesa për azil arriti 4.000 në vetëm një muaj. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti, norma e pranimit të kërkesave në Gjermani ishte afër zeros. Nga 5.000 kërkesave për azil të cilat janë ekzaminuar në këtë periudhë, vetëm 11 persona kanë marrë mbrojtje humanitare (e cila nuk është azil politik dhe është dhënë vetëm për shkak të problemeve serioze shëndetësore të paraqitura). Kjo tregon natyrën abuzuese të kërkesave të cilat kanë si arsye kryesore mungesën e kujdesit shëndetësor, të shkollimit dhe papunësinë në vendet e origjinës. Ndonëse nuk përbejnë shkak për azil, qeveritë e vendeve të Ballkanit duhet të adresojnë këto probleme në vendet e tyre sepse pasojat mund të shkojnë përtej dënimeve të individëve. Shpesh institucionet shtetërore mbyllin sytë kundrejt pabarazive të thella sociale e diskriminimit në ofrimin e shërbimeve për grupe apo shtresa të caktuara të popullsisë. Pasojat e indiferencës shtetërore më pas shfaqen në problematika të ndryshme që vendosin vendin në situata të vështira që mund të kthejnë mbrapa procese



të rëndësishme si dhe të ulin besueshmërinë kundrejt partnerëve ndërkombëtarë. Nevojitet që vendi të trajtojë këto çështje më seriozisht e me perspektiva afatgjata përtej fushatave informuese e deklaratave politike.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2012

Kartolina nga BE-ja

Pesë mite të pavërteta mbi shkatërrimin e Europës

Sipas një analize të Indermit Gill, publikuar në Europe's World, Amerika dhe Azia kanë perceptime të gabuara mbi Europën, pasi disa mite të pavërteta qarkullojnë mbi falimentimin e saj. Ai sfidon pesë prej tyre:

- Miti që Europa është në rënie:** Në fakt ajo nuk është. Një mënyrë për ta treguar këtë është madhësia e ekonomisë së Europës, prodhimi i brendshëm bruto. Për vitet 2000, Europës i takon një pjesë e qëndrueshme e prodhimit global, rreth 30%, ndërsa pjesa e prodhuar nga SHBA në fakt ka rënë nga 31% në 23%. Gjatë dy dekadave të fundit, PBB i Europës u rrit me rreth 2% në vit, pak më shumë se Shtetet e Bashkuara.
- Miti që financat e Europës janë më të këqijat në botë:** Ato mund të jenë ndër më të mirat. Paratë duhet të rrjedhin nga vendet e pasura, me rritje ekonomike të ngadaltë tek ato që janë të varfra dhe me rritje të shpejtë. Megjithatë, në shumë vende të botës, kemi parë të ndodhë e kundërta - le ta quajmë atë "sindroma e Kinës". Vendet që kanë dërguar të holla në Europën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara kanë pasur rezultate më të mira se ato që u përpoqën të bëjnë atë që duket më e arsyeshme – të marrin hua jashtë vendit, të investojnë brenda vendit dhe të sigurojnë rritje më të shpejtë. Për më tepër sot në Europë, vendet ish komuniste kanë sistemet bankare më të përparuara në botë. Sigurisht, herë
- Miti që sipërmarrjet europiane nuk janë konkurruese:** Edhe pse problemet ekzistojnë, numrat tregojnë një realitet ndryshe. Ndërkohë Azia pati një krizë të zhurmshme ekonomike në fund të viteve 1990, e ndjekur nga një bum i madh ekonomik, dhe SHBA-të shpikën një revolucion produktiviteti dhe një shembje financiare, ndërmarrjet europiane kanë lulëzuar në heshtje. Mes viteve 1995 dhe 2009, sipërmarrësit e Europës Perëndimore kanë krijuar vende pune më shpejt sesa ato në SHBA. Ekonomitë europiane kanë rritur eksportet në krahasim me Brazilin, Rusinë, Indinë dhe Kinën dhe kompanitë në Europën Lindore kanë rritur produktivitetin më shpejt se ato në Azinë Lindore.
- Miti që qeveritë europiane janë shumë të mëdha:** Kjo është relative. Qeveritë në Europë janë më të mëdha - ato shpenzojnë rreth 10% të PBB-së më shumë se homologet e tyre jo-europiane. Pothuajse e gjithë kjo është për shkak të vetëm një arsyeje: ato të shpenzojnë më shumë për mbrojtjen sociale - pensionet, sigurimi i papunësisë dhe mirëqenies. Ky është thelbi i modelit social europian. Ai ka ndihmuar që Europa bëhet "superfuqi mirëqenieje" në botë. Cilësia e jetës në ekonomitë e përparuara europiane është ndoshta më e mira në historinë e njerëzimit.
- Miti që Europa duhet ta braktisë modelin e saj ekonomik:** Europa ka nevojë ta rregullojë qasjen e saj, por jo ta braktisë atë. Disa pjesë të modelit, si tregtia dhe financat funksionojnë, edhe pse ato mund të përmirësohen. Pjesë të tjera të modelit, të tilla si ndërmarrjet, funksionojnë mjaft mirë në shumë vende, edhe pse qeveritë në Greqi, Itali dhe



Spanjë duhet të përmirësojnë kushtet e të bërit biznes. Më shumë se gjysma e 30 vendeve të para në botë për suksesin biznes janë në Europë. Islanda dhe Irlanda janë ndër dhjetë më të mirat. Greqia është në vendin 100. Problemi më i madh i saj mbeten rregullat që e komplikojnë zhvillimin e biznesit atje.

Europe's World, vjeshtë 2012

Sfidat e luftimit të korrupsionit: A duhet të ketë BE-ja rol më të madh?

Nëse mendoni se Bashkimi European është i përfshirë në shumë çështje tashmë, prisni derisa planet e tij ambicioze për mbikëqyrje në fushën e drejtësisë europiane, prokurimit dhe korrupsionit të shpalosen plotësisht. Ideja më e fundit është një propozim nga Vivian Reding, Komisionerja Europiane për Drejtësi, për të rishkruar traktatin e BE-së në mënyrë që të lejojë një prokuror publik europian të gjurmojë dhe burgosë të dyshuarit për përvetësim të fondeve të BE-së. Por ky s'është i vetmi projekt super-ambicioz në BE.

Ka fakte që argumentojnë për plane të tilla. Si fillim është humbja e buxhetit të BE-së: Reding argumenton se "shifra reale" për mashtrim është "shumë më e lartë" se 600 milion euro raportuar vitin e kaluar. Megjithatë kjo varet se si ne e përcaktojmë mashtrimin. Studiuesit e dinë se shtetet europiane me shkallë më të lartë korrupsioni kanë më shumë gjasa të krijojnë defiçite fiskale. Kjo do ta bënte paktin fiskal të justifikueshëm si një hap "anti-korrupsioni", edhe pse pak njerëz do të guxonin të shpreheshin kështu.

Së dyti, qëndron fakti se në shumë vende të Europës jugore dhe lindore fondet e BE-së janë shpërndarë për bizneset e favorizuara nga parti të caktuara. Kjo nuk është asgjë e re dhe jo çdo parlament kombëtar do ta konsideronte një sjellje të tillë si të paligjshme, por ky është rast kur ky favorizim i qeverisë do të thotë se kompanitë që nuk gëzojnë lidhjet politike janë të humbura.

Gjithashtu këto shqetësime ekzistojnë dhe në opinionin publik: në një sondazh të fundit nga Eurobarometër qytetarët europianë janë ankuar shumë për korrupsionin, sidomos ata që jetojnë në vende ku korrupsioni është i përhapur janë shumë kritikë ndaj politikave të qeverisë së tyre kombëtare.

Por çfarë ka ndodhur që nga zgjerimi?

Regres

Në Europën Qendrore, që nga hyrja në BE në vitin 2004 shumica e shteteve të reja anëtare kanë ngecur në kontrollin e korrupsionit. Raportet e fundit të BE-së në Rumani kanë vlerësuar institucionet anti-korrupsion të vendit, që megjithatë nuk kanë penguar përhapjen e mashtrimit në trajtimin e fondeve të BE-së, duke çuar gati në ndërprerjen e tyre dhe në akuzimin e kreut kombëtar të zyrës së taksave për favorizim të evazionit fiskal.

Estonia është shembulli i progresit në vendet e reja anëtare por dhe kjo jo në sajë të BE-së por të aplikimit të politikave neo-liberale dhe skandinave. Dhe madje edhe shtetet e vjetra anëtare nuk janë bastionet e dikurshme: renditja e fundit të Bankës Botërore tregon regres në Austri, Greqi, Portugali dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Rreziqet me të cilat përballet BE-ja në qoftë se ajo vepron janë po aq të mëdha sa përfitimet, veçanërisht në qoftë se këto rreziqe nuk janë kuptuar mirë. Si fillim, ndërhyrja nga BE-ja mund të përballet me mungesë besueshmërie në vendet që i kanë ndërtuar vetë me sukses sistemet e qeverisjes së mirë. Mjaftojnë dy klikime në faqen e internetit të çdo qeverie skandinave për të mësuar se cila fondet janë disbursuar dhe se si janë zgjedhur kontraktorët. Është shumë më e vështirë të kuptohet kjo në rastin e institucioneve europiane, ku edhe disa drejtoritë të përgjithshme nuk janë në dijeni të asaj që bëjnë departamentet e tjera.

Një rrezik i dytë është ai i "mono-ndërtimit institucional" - me fjalë të tjera, për shkak të mungesës së njohurive specifike të një vendi,



të rekomandohen institucione të ngjashme me vendet që mund të kenë probleme shumë të ndryshme. A duhet Suedia të krijojë një institucion të veçantë për të menaxhuar paratë e BE-së kur prokurimi i saj funksionon shumë mirë ashtu siç është? Industria e anti-korrupsionit është inefficente veçanërisht si pasojë e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e cila u rekomandon të gjithëve të krijojnë agjenci të veçanta anti-korrupsion, pavarësisht dëshmive statistikore se vendet që i kanë ngritur ato nuk kanë përparuar dukshëm më mirë se tjerët.

Rreziku i tretë është se përpjekja për të frenuar korrupsionin mund të gllabërohet nga rritja e shpejtë e industrisë së anti-korrupsionit, një industri të ardhurat e së cilës janë rritur shpejt gjatë 15 viteve të fundit, pavarësisht nga ndikimi i vogël.

European Voice, 18 tetor 2012

Aksi Franko – Gjerman në krizë? Ndërkohë Merkel parashikon një Europë federale



Samiti i fundit i Bashkimit European vuri në dukje dallimet e thella mes kancelares gjermane Angela Merkel dhe presidentit francez François Hollande. Berlini kërkon që Brukselit t'i jepet më shumë fuqi mbi buxhetet kombëtare, madje kohët e fundit Merkel ka shprehur bindjet e saj federaliste sipas të cilave një ditë Komisioni European do të kthehet në qeveri, Këshilli i Ministrave në një "Dhomë të lartë" dhe Parlamenti European do të fitojë më shumë fuqi. Ndërkohë Parisi po bën thirrje për dhënien fund të masave të kursimit dhe në tërësi pakënaqësitë për qëndrimet e Gjermanisë po rriten. Mosmarrëveshja mund të intensifikojë e krizën së euros.

Një nga metodat e vjetra të politikës është të transformojë edhe lajmet më të mrekullueshme në mesazhe mosmarrëveshjeje. Çka është e re është se qeveritë në Paris dhe Berlin duken veçanërisht të afta në këtë disiplinë të çuditshme.

Liderët e 27 vendeve të Bashkimit European ishin mbledhur për një samit krize kur kancelarja gjermane Merkel i surprizoi të gjithë me një propozim të ri. Po sikur të gjithë në samit të niseshin për në Oslo në dhjetor e të pranonin bashkarisht Çmimin Nobel për Paqe, si një shenjë të unitetit european?

Reagimet e liderëve të tjerë europianë ishin të rezervuara. Kryeministri italian Mario Monti tha se duhet të jetë e mjaftueshme që drejtuesit e Komisionit European, Këshillit të Ministrave të Europës dhe Parlamentit European të bëjnë udhëtimin. Kryeministri britanik David Cameron propozoi dërgimin e një fëmijë nga çdo shtet anëtar në Oslo. Së fundi, çështja u vendos kur presidenti francez François Hollande hodhi poshtë idenë e një udhëtimi të përbashkët kur ai u shpreh me sarkazëm: "Unë nuk jam suplementar"

Ekipi më i fuqishëm politik i Europës nuk është në gjendje të gjejë një emërues të përbashkët për pyetjen se kush duhet të marrë çmimin, dhe veçanërisht me çështjen shumë më të rëndësishme të shpëtimit të euros. Në samitin e Brukselit, Merkel dhe Hollande, pas debateve për orë të tëra, ranë dakord mbi një kompromis mbi bashkimin bankar, ndërkohë që të gjitha çështjet tjera të diskutuara mbetën të pazgjidhura.

Që nga kohët e ish-kancelarit gjerman Adenauer dhe ish presidentit francez Charles de Gaulle, Gjermania dhe Franca janë drejtuar përgjithësisht nga politikanë të cilët kanë dhënë më shumë vlerë në unitet se në dallimet mes tyre.

Nën drejtimin e Merkel dhe Hollande, partneriteti gjermano-francez rrezikon të përkeqësohet dhe kthehet veç në një fasadë. Të dy politikanët, të cilët mbajnë fatin e kontinentit në duart e tyre, përshëndesin njëri-



tjetrin me mirësjellje me puthje në faqe, dhe përfaqësuesit e tyre të marrëdhënieve publike lartësojnë bashkëpunim e tyre “profesional” dhe “të besueshëm”.

Hollande nuk dëshiron të falë Merkel që ka bërë fushatë për kundërshtarit e tij konservator, ish presidentin Nicolas Sarkozy. Tani Kancelaria dyshon se Hollande po planifikon fshehurazi një fushatë për kundërshtarit e Merkel nga Partia Social Demokratike (SPD), ish-ministrin e financave Peer Steinbrück.

Mosbesimi modelon marrëdhëniet midis Parisit dhe Berlinit, në çështjet që variojnë nga sistemi i bankës europiane në hapësirën ajrore të përbashkët dhe arkitekturën e ardhshme të Europës. Hollande dyshon se Berlioni po përdor konsolidimin e buxhetit si një justifikim për të fituar dominimin europian. Merkel shprehet se Hollande po bashkohet me forcat e Romës dhe Madridit për të formuar një aks të përbashkët kundër Gjermanisë.

Një takim i hidhur

Ishte e qartë për të gjithë pasi panë Merkel dhe Hollande të dilnin nga dhoma e konferencave të Këshillit se takimi i tyre privat kishte përfunduar me një shije të hidhur. Të dy politikanët dukeshin të tensionuar kur flisnin me njëri-tjetrin, por para intervistuesve dhanë buzëqeshje. Vazhdon prej muajsh situata ku ata shtiren në publik, por në realitet Merkel dhe Hollande jetojnë në universe paralele. Pikëpamjet e tyre të botës nuk mund të jenë më ndryshe.

Spiegel, 22 October 2012

Franca legalizon martesat gay

Presidenti Hollandë e ka mbajtur premtimin elektoral për legalizimin e martesave gay në Francë. Para pak ditësh, qeveria franceze ndryshoi ligjin për martesat duke lejuar bashkimin mes personave të të njëjtit seks dhe duke zëvendësuar fjalët “nënë” e “baba” me “prindër”. Kjo do të thotë që tashmë çiftet

gay mund të adoptojnë fëmijë. Vendimi ishte vonuar për shkak të kundërshtimeve të partive konservatore dhe institucioneve fetare, në veçanti kishës katolike.

Megjithatë, garantimi i mundësive të barabarta për personat homoseksualë është i rëndësishëm në një demokraci si Franca. Presidenti Hollande e cilësoi miratimin e martesave gay si një progres për shoqërinë. Sipas Shqatës së personave gay dhe lesbike, në Francë përlllogaritet që rreth 300 000 fëmijë kanë prindër homoseksualë.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2012

Në pritje të aderimit...

Një vështrim mbi progresin e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së gjatë vitit 2012

Si çdo vit, në fillim të muajit tetor Komisioni European publikoi paketën e Zgjerimit 2011 – 2012 për vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqinë dhe Islandën. Krahas analizimit të hollësishëm që i bën progresit të secilit vend në kuadër të përmbushjes së standardeve europiane, ky dokument prezanton gjithashtu edhe vizionin e KE-së për politikën e zgjerimit për vitin e ardhshëm. Vjeshta solli lajme të mira për disa nga vendet, edhe pse panorama e përgjithshme vë në dukje ritmin e ngadaltë të reformave në Ballkan.

Kroacia – Progres pozitiv është evidentuar në rrugëtimin e vendit drejt anëtarësimit në BE si dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit me *acquis*. Megjithatë, KE ka identifikuar disa nga fushat kryesore (*si politika e konkurrencës, gjyqësori, të drejtat themelore të njeriut – veçanërisht efikasiteti i gjyqësorit- drejtësia, liria dhe siguria*) ku ende nevojiten rezultate. Është thelbësore që Kroacia të fokusojë potencialin e saj për të siguruar që përgatitjet për anëtarësim (parashikuar në verën e 2013) të realizohen në kohë.



Mali i Zi – Progres pozitiv është arritur në kuadër të përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit. Hapja e negociatave për anëtarësimit në qershor të 2012 ishte tregues i këtij progresi. Procesi i *screening* ka filluar dhe pritet të përfundojë në verën e 2013. Një qasje e re po adoptohet në kuadër të negociatave të anëtarësimit lidhur me kapitujt mbi gjyqësorin, të drejtat themelore dhe lirinë, kapitujt e drejtësisë dhe të sigurisë, duke përforcuar fokusin tek shteti i së drejtës. Gjatë negociatave, Mali i Zi do të duhet të zhvillojë një historik solid të dhënash në këtë fushë me qëllim zbatimin e pakthyeshëm të reformave. Fokusi vihet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë edhe atë të nivelit të lartë.

Maqedonia - KE arrin në përfundimin se vendi ka vazhduar përmbushjen me sukses të kriterit politik të anëtarësimit. Për të katërtin vit resht Komisioni propozon hapjen e bisedimeve me Maqedoninë, të cilat janë bllokuar nga Greqia për shkak të çështjes së emrit.

Serbia – Në mars të 2012, Këshilli i akordoi Serbisë statusin e vendit kandidat. KE vlerëson se vendi është në rrugën e duhur për përmbushjen e kriterit politike të anëtarësimit dhe kushteve që derivojnë nga procesi i Stabilizim-Asociimit. Është e nevojshme që të vazhdohen reformat si dhe të përmirësohen dukshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme marrëdhëniet me Kosovën. Në përputhje me rekomandimin e saj në Opinionin e 2011, KE është e gatshme të konfirmojë që negociatat për anëtarësimit të hapen, me kusht që përparimi drejt normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën të jetë realizuar me sukses.

Shqipëria – Progres pozitiv është bërë drejt përmbushjes së kriterëve politike për anëtarësimin, duke realizuar një numër reformash që adresojnë 12 prioritetet kyçe të KE. Për këtë qëllim KE i rekomandon Këshillit dhënien e statusit të vendit kandidat me kusht përmbushjen e reformave të tjera kyçe në fushën e gjyqësorit, parlamentit dhe administratës publike. KE do të vlerësojë angazhimin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe

krimit të organizuar. Ndërkohë për fillimin e negociatave për anëtarësim, Shqipërisë i duhet në mënyrë të veçantë të tregojë zbatimin e qëndrueshëm të angazhimeve të ndërmarra tashmë dhe të përmbushë plotësisht 12 prioritetet e vendosura nga BE-ja që në vitin 2010, që kanë të bëjnë me zgjedhjet, sundimin e së drejtës, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Zgjedhjet parlamentare të 2013 do të jenë një provë vendimtare në këtë drejtim dhe një parakusht për çdo rekomandim në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE.

Bosnje – Hercegovina – KE konkludoi se vendi ka bërë progres të kufiazuar në drejtim të përmbushjes së kriterëve politike dhe krijimit të strukturave institucionale më funksionale dhe të qëndrueshme. Nevoja për një mekanizëm koordinues efektiv midis niveleve të ndryshme të qeverisjes mbi çështjet e integritetit evropian mbetet për t'u adresuar si një çështje prioritare. Në këtë aspekt, është zhgënjyese se rezultatet deri më tani mbetet të nën nivelin e pritshmërive.

Kosova – Raporti i fizibilitetit dëshmoi se vendi është gati për fillimin e negociatave në kuadër të MSA. KE do të propozojë direktivat e negociimit për një marrëveshje të tillë pasi Kosova të ketë bërë përparim në përmbushjen e disa prioritetëve afatshkurtra. Raporti finalizohet duke përmendur se është e nevojshme që Kosova të përmbushë detyrimet e saj në kuadër të MSA që lidhen me: sundimin e ligjit, gjyqësorin, administratën publike, reformat zgjedhore dhe parlamentare, të drejtat themelore të njeriut, mbrojtjen e minoriteteve, çështjet e tregut të brendshëm dhe tregtisë, ato fito-sanitare dhe veterinare.

Stafi i EuroSpeak, tetor 2012

Banka Botërore ngre alarmin për nivelet e borxhit dhe rënien ekonomike në Ballkanin Perëndimor

“Unë do të thoja se borxhi në Mal të Zi, Serbi dhe Shqipëri është në nivele shumë të rrezikshme, sidomos në Shqipëri ku ka arritur në 60% të PBB-së. Rritje mjaft të shpejtë të këtij



niveli po pëson edhe Serbia dhe Mal i Zi”, tha për Reuters në një intervistë Jane Armitage, koordinatoreja e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.



Parashikimi i bankës për Serbinë, ekonominë më të madhe të rajonit, ishte më pesimisti, pasi vendi lufton për të nxitur rritjen ekonomike ndërsa vazhdon të rrisë deficitin e tij buxhetor. Shqipëria dhe ish republikat e Jugosllavisë kanë pasur një rënie të eksporteve dhe të investimeve të huaja për shkak të krizës së borxhit në euro-zonë. Faktorë të tjerë si rënia e remitancave, ndikimi i dimrit të gjatë e të ashpër dhe verës së nxehtë në sektorin bujqësor dhe prodhimin e energjisë janë shenja të mjaftueshme për fillimin e një recesioni ekonomik. Sipas Armitage, vetëm Kosova ka të ngjarë të vazhdojë të ketë rritje ekonomike në sajë të nivelit të ulët të integritimit me tregun europian, nivelit të ulët të borxhit dhe investimeve të mëdha në infrastrukturë.

Koordinatorja për Ballkanin Perëndimor parashikon një rritje mjaft të ngadaltë të ekonomisë për vitin e ardhshëm. Ajo bën thirrje për konsolidim të sistemit fiskal dhe ulje të nivelit të borxhit, por në të njëjtën kohë pranon nevojën e investimeve në infrastrukturë.

Bashkimit European i akordohet çmimi Nobel për Paqen, mes kritikave dhe ironizimit...

Çmimi i Nobel për Paqen, akorduar BE-së pak kohë më parë është pritur me jo pak debate dhe ironizime. Kriza financiare që ka kapluar Europën mund të shkatërrojë Euron dhe bashkë me të edhe projektin European. Presidenti i komitetit të Nobel-it, Thorbjørn Jagland gjatë

dhënies së çmimit pranoi problemet aktuale të BE-së, por pohoi se komiteti është përqendruar në punën e BE-së për 6 dekada në promovimin e paqes, demokracisë dhe të drejtave themelore të njeriut. Çmimi i Paqes është menduar si një kujtesë e asaj që BE-ja ka arritur në kuadër të transformimit të Europës “nga një kontinent i luftës në një kontinent të paqes”. Mirëpo, ky do të ishte një lexim jo i plotë i historisë nëse nuk do të përmendnim se NATO-ja dhe prania e forcave amerikane kanë qenë një faktor po aq, dhe ndoshta edhe më i rëndësishëm në ruajtjen e paqes në Europë. Ishte ndërhyrja e Amerikës me shumë sesa e Europës, qoftë si unitet i përbashkët ashtu edhe individualisht, që pengoi gjakderdhjen në ish-Jugosllavi. Megjithatë, çmimi është një inkurajim për BE-në dhe kontributin e saj për paqen, ripajtimin, prosperitetin, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Deklarata të shumta nga disa prej përfaqësuesve më të lartë të BE-së kanë komentuar këtë çmim ndër të cilët edhe Barroso, i cili u shpreh: “... Unë besoj se çmimi vjen në kuadër të njohjes së punës së bërë nga BE-ja jo vetëm në bashkimin e kontinentit, por edhe jashtë Europës tonë. Projekti europian filloi me gjashtë shtete dhe ne tashmë jemi 27, një tjetër do të na bashkohet vitin e ardhshëm dhe shumë të tjerë në vitet në vazhdim. BE-ja është projekti më i rëndësishëm për paqen në terma bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbi-kombëtar. Çmimi i Paqes dëshmon se në këto kohë të vështira, BE-ja mbetet një frymëzim për vendet dhe njerëzit në të gjithë botën dhe se komuniteti ndërkombëtar ka nevojë për një BE të fortë.” Ndërkohë, ky lajm nuk ka kaluar pa kritikën e euroskeptikëve. “Një çmim Nobel për BE-në në një kohë kur Brukseli dhe të gjithë vendet Europiane janë në kolaps. Çfarë tjetër? Një Oscar për Van Rompuy?” ishte komenti ironizues i politikanit të së djathtës ekstreme holandeze, Geert Wilders në Twitter.

Stafi i EuroSpeak, tetor 2012

Amnesty International kritikon Republikën Serbe të Bosnjës për mos dënimin e përdhunimeve gjatë luftës



Organizata për të drejtat e njeriut Amnesty International i bëri thirrje Republikës Serbe të Bosnjë Hercegovinës për t'i dhënë dëmshpërblime të mbijetuarve të dhunimeve gjatë luftës.

Në një deklaratë të lëshuar të enjten, AI tha se autoritetet Serbe Boshnjake nuk kanë bërë asnjë përpjekje domethënëse për të adresuar nevojat e viktimave.

John Dalhulsen, drejtori i programit i Amnesty për Europën dhe Azinë Qendrore u shpreh "dështimi për t'i siguruar drejtësi të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës duhet të paktën të nxirret në dritë në mënyrë që të mbijetuarit të rindërtojnë jetët dhe familjet e tyre". Ai shton që "drejtësia e të mbijetuarve kërkon ndjekjen penale të autorëve të krimit dhe njohjen e pasojave të abuzimeve të tyre.

Amnesty gjykon se që nga fillimi i luftës në Bosnje 1992 e gjer në 1995, ka mbledhur dëshmi të shumta të grave që kanë qenë subjekt i përdhunimeve sistematike, skllavërimit seksual, shtatëzanisë së detyruar dhe të krimeve të tjera të dhunës seksuale.

Organizata e të drejtave thekson se shumë nga të mbijetuarit kanë përjetuar çrregullime mendore, stres post-traumatik dhe probleme të tjera psikologjike, duke përfshirë depresion, kujtesë të fragmentuar, mungesë përqendrimi, makthe dhe ankth. Mijëra gra myslimane janë përdhunuar nga forcat serbe në zonat ku këta të fundit kanë pushtuar gjatë luftës.

Amnesty International përfundon se nga dhjetëra mijëra raste të dokumentuara, më pak se 40 raste janë ndjekur penalisht nga Gjyqi Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavisë apo nga gjyqet lokale të republikës.

Spiegel, 22 tetor 2012

Erdogan: BE-ja do ta humbë Turqinë nëse ajo nuk anëtarësohet deri në 2023



Kjo është hera e parë që Erdoğan ka dhënë një tregues se për sa kohë Ankaraja mund të vazhdojë rrugën drejt BE-së. Këto

deklarata vijnë në një kohë të një tjetërsimi në rritje të marrëdhënieve mes Turqisë dhe një entiteti politik, i cili gjykohet të jetë sjellë mjaft ftohtë kundrejt Turqisë.

I pyetur gjatë një diskutimi në Berlin nëse Turqia do të jetë anëtare e BE-së deri në 2023, Erdoğan është përgjigjur se "nuk besoj se ata do të na zvarrisin kaq gjatë. Por nëse kjo ndodh, BE-ja do të humbë shumë, të paktën do të humbi Turqinë". Vendi me mbizotërim mysliman, por laik, i rreth 74 milion banorëve do ta forconte BE-në. "Rreth 6 milion turq tashmë jetojnë në BE, dhe rreth 3 milion prej tyre në Gjermani" tha ai.

Edhe pse ministri i jashtëm gjerman, Guido Westerwelle, mbështet aspirimin e Turqisë, Kancelarja gjermane, Angela Merkel, kundërshton një anëtarësim të plotë në BE, por favorizon një partneritet të privilegjuar. Turqia ka mbullur vetëm një nga 35 kapitujt e politikave që duhet të përfundohen nga çdo vend kandidat. Të gjithë kapitujt, përveç 13 prej tyre janë bllokuar, çka shtyn Komisionin Europian të deklarojë se Turqia nuk i ka përmbushur standardet e kërkuara, sidomos për sa i përket të drejtave të njeriut dhe lirisë së fjalës.

EurActiv, 31 tetor 2012



A E DINI SE?

Gjermania Lindore: shoqëria më ateiste në botë

Ateizmi i Gjermanisë Lindore mund të shihet si një formë e një identifikimi të vazhdueshëm politik dhe rajonal - dhe një perceptim për të ardhmen.

Një studim i kohëve të fundit i quajtur "Besimet rreth Perëndisë në kohë nëpër shtete" zbuloi se 52.1% e njerëzve të pyetur nëse besonin në Zot u identifikuan si ateistë. Kjo shifër e krahasuar me vetëm 10.3% në Gjermaninë perëndimore. Studimi në Gjermaninë lindore nuk ishte në gjendje të gjente një person të vetëm nën moshën 28-vjeçare që besonte në Zot. Në vështrimin e parë kjo është një gjetje e jashtëzakonshme, por ka nevojë për disa sqarime të kujdesshme.

Janë paraqitur disa shkaqe të kësaj mungese besimi. Së pari është fakti se kjo zonë ishte e drejtuar nga Partia Komuniste nga 1945 në 1990 dhe se armiqësia e saj e qartë kundrejt fesë e shtypi atë me forcë. Megjithatë, kjo nuk është e tërë çështja. Në fakt, pas armiqësive në vitet e para të GDR (Republikes Demokratike Gjermane), SED (Partia Uniteti Socialist i Gjermanisë) arriti relativisht në një situatë të volitshme në sajë të asaj që u quajt Kisha në Socializëm. Kishave në RDGJ iu dha një shkallë e lartë autonomie, duke u bërë kështu fokusi organizativ i lëvizjes disidente të viteve 1990, kjo e fundit e udhëhequr nga një farë mase nga pastorë protestantë.

Partia krijoi pole alternative të integritit për popullsinë. Të rinjtë u sollën në një atmosferë tejet ideologjike dhe u detyruan t'i nënshtrohen të ashtuquajturit *Jugendweihe* - një lloj konfirmimi ateist.

Një faktor tjetër është se feja në Gjermaninë lindore është kryesisht protestante, si historikisht dhe në kushtet bashkëkohore. Nga 25% të popullsisë që identifikohen si fetarë,

21% e tyre janë protestantë. 4% i mbetur është i përbërë nga një numër i vogël i katolikëve, i muslimanëve dhe i përkrahësve të grupeve të reja evangjeliste, sekteve apo feve alternative. Kisha Protestante është në rënie me dy herë çdo vit si pasojë e largimit të shumë njerëzve.

E gjitha kjo tregon është se pjesa lindore e Gjermanisë ka një identitet i cili për gati një çerek shekulli vazhdon ta bëjë bashkimin më të vështirë se sa pritej. Besimi fetar ose më mirë mungesa e tij, luan një rol të rëndësishëm në këtë. Kjo ka bërë që disa të flasin për ateizmin e Gjermanisë Lindore si një formë të vazhdueshme identifikimi politik dhe rajonal. Për shembull, në vitin 2000 teologu katolik Eberhard Tiefensee identifikoi atë që ai e quajti një "ateizëm popullor të Gjermanisë Lindore", i cili përbën një pjesë të konsiderueshme të një identiteti rajonal kundër dominimit katolik të Gjermanisë perëndimore. Laicizmi po përhapet në të gjithë kontinentin dhe roli i fesë e i kishës në modernizëm po vihen në pyetje gjithandaj, duke filluar me martesën e homoseksualëve, gratë e priftërinjve, aborti e më tej te çështja nëse BE-ja duhet të identifikojë veten si një entitet të krishterë. Pyetja duhet të jetë nëse në të vërtetë popullsia ateiste përfaqëson të ardhmen e Europës.

The Guardian, 22 shtator 2012

Moldavët, populli më i varfër në Europë

Qytetarët në Lihtenshtejn janë më të pasurit në Europë, ndërkohë që Moldavët janë 45 herë më të varfër, tregon një studim gjerman, i cili i vendos spanjollët afër me vlerën e fuqisë mesatare blerëse europiane prej 13,000 € në vit. Studimi, i realizuar në 42 shtete nga GfK Geo Marketing, analizon të ardhurat e individëve dhe kursimet pas pagimit të taksave.

Lihtenshtejn - shteti i vogël jo anëtar i BE-së i kufizuar me Austrinë dhe Zvicrën, kryeson renditjen me 57,000 € për person në vit. Shteti alpin karakterizohet si një strehë me taksë të ulët, me më shumë kompani të regjistruara sesa qytetarë dhe me lulëzim të shërbimeve financiare. Fqinji i tij Zvicra - me të cilin ndan



A E DINI SE?

monedhën - listohet i treti, pas Norvegjisë të pasur me naftë, kjo e fundit po ashtu jo anëtare e BE-së.



Më i pasuri për nga kapitali nga shtetet e BE-së është Luksemburgu - gjithashtu një shtet i vogël me taksa të ulëta, i orientuar në sektorin financiar. Qytetarët kanë gjysmën e asaj që qytetarët e Lihtenshtejnit mund të shpenzojnë pas pagimit të taksave: 28,924€ në vit. Kjo është gjithsesi dyfishi i asaj mesatareje europiane të vëzhguar në Spanjë dhe në Italinë jugore: rreth

13,000 €. Në anën tjetër qëndrojnë shtetasit Moldavë, Bjellorusë dhe Kosovarë, të cilët fitojnë 10 herë më pak se mesatarja europiane.

Pabarazitë regionale janë të larta në disa shtete - me banorët parizienë që janë dyfish më të pasur se mesatarja e tyre kombëtare, ndërkohë çereku i pasurisë së Bullgarisë është e përqendruar në kryeqytet, Sofie. Danimarka, që renditet e pesta për fuqinë blerëse, ka shpërndarjen më të barabartë mes krahinave: në Kopenhagen fitohen 23,442 € ndërkohë pasuria më e ulët për kapital është parë në Jutlandën veriore, në vlerën 21,003 €. Studimi gjithashtu shqyrton pasurinë totale në Europë, dhe e vendos Gjermaninë në krye, të ndjekur nga Franca dhe Mbretëria e Bashkuar.

Tre ekonomitë më të mëdha në BE zotërojnë pothuajse gjysmën e fuqisë blerëse në Europë, me 53% e mbetur të ndarë mes 39 shteteve të tjera. Polonia dhe Turqia, ku fuqia blerëse për kapital është poshtë mesatares, janë gjithashtu mes 10 shteteve kryesuese në pasurinë totale.

EU Observer, 31 tetor 2012

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, si dhe Programit Europe for Citizens të Komisionit European.



Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në faqen e internetit të Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org